

10

rretho 10

10 ARSYE PSE DUHET VOTUAR

Më mirë për Tetovën

#logaridhënie #ambienttëpastër #qytetmeplan



1. Më mirë për Tetovën nuk është parti politike që udhëhiqet nga interesat partiake, por është iniciativë e pavarur qytetare që lufton për të mirën e Tetovës. Partitë janë mësuar vetëm të marrin nga Tetova. Ne duam të krijojmë kulturë që t'i japim Tetovës, e jo të marrim prej qytetit tonë!

2. Më mirë për Tetovën është e përbërë nga qytetarë të dëshmuar si profesionistë dhe aktivistë, të cilët veprojnë në shërbim të mirëqenies së përgjithshme. Parimi i meritokracisë së dëshmuar dhe profesionalizmi janë shtyllat kryesore të aktivistëve tonë.

3. Këshilltarët e Më mirë për Tetovën ishin më aktiv në Këshill. Diskutimet e tyre ishin përmbajtësore dhe të bazuara në argumente. Mbi të gjitha, ata sakrifikuan më tepër se të tjerët. Rrogat që u takonin me shumë meritë, i dhuruan për organizata bëmirëse që punojnë në dobi të qytetit.

4. Dalja në skenë e Më mirë për Tetovën solli një frymë të re: Tetovarët për herë të parë votuan për këshilltarë me biografi të publikuara, programe parazgjedhore dhe figura konkuresse.

5. Më mirë për Tetovën me angazhim të drejtpërdrejtë, inicoi dhe e ngriti nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në komunë. Seancat e këshillit tani ndiqen drejtpërdrejtë (online), si dhe të gjitha materialet ndahen me publikun.

6. Ashtu siç premtoi, Më mirë për Tetovën luajti rol kyç në pezullimin e planit urbanistik të Shik Jellakut.

7. Këshilltarët e Mirë për Tetovën ishin më aktivët. Inicua debate publike për ndërtimet pa leje, kaosin urbanistik, buxhetin e komunës dhe harxhimet e shkollave, si dhe me ekspertët tonë ofruam zgjidhje për problemin me qentë endacak.

8. Transparenca dhe llogaridhënia në nivel lokal do të plotësohet nga plani ynë për rritje të pjesëmarrjes qytetare nëpërmjet platformave inovative, si faktor kyç në përgatitje të strategjive, programeve dhe buxhetit vjetor.
































9. Strategjia jonë ka për qëllim sigurimin e ujit të pijshëm, ajrit të pastër, ambientit të pastër, dhe hapësirave të gjelbra si elemente thelbësore jetike.

10. Qytetit i ofrojmë zgjidhje të integruara për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet planifikimit hapësinor të qëndrueshëm, transportit dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme, sigurimit të hapësirave për personat me nevoja të veçanta, digjitalizim të shërbimeve dhe krijimit të qendrave rinore.



ZGJEDHJET PËR KËSHILLIN KOMUNAL - 20 GUSHT 2022

Lista e këshilltarëve “Më mirë për Tetovën”

-  **Elmedina Abdullahi** | bartëse liste
etnologe
-  **Hamdi Sulemani**
arkitekt
-  **Merita Maksuti**
arkitekte
-  **Ngadhujim Mehmeti**
dizajner grafik
-  **Fortesa Asani**
hulumtuese në sektorin civil
-  **Zeqir Vica**
teknik i sistemeve solare
-  **Agon Memedi**
hulumtues në shkencë kompjuterike
-  **Fjolla Ibraimi**
këngëtare
-  **Arif Arifi**
dentist
-  **Nasuf Nebiu**
arkitekt
-  **Leona Murati**
studente e biokimisë
-  **Fisnik Shabani**
arsimtar i gj. frenge
-  **Fatos Lumani**
kompozitor
-  **Merita Saiti**
politikologe
-  **Ilir Vela**
kirurg
-  **Shqipron Osmani**
menaxher marketingu
-  **Sara Velii**
arkitekte
-  **Vullnet Neziri**
oboist
-  **Burim Islami**
dizajner grafik
-  **Merjem Emiri**
arsimtare
-  **Florent Bajrami**
trajnuar për udhëheqje të projekteve
-  **Mentar Mahmudi**
hulumtues i inteligjencës artificiale
-  **Nora Sulejmani**
studente e shkencave politike
-  **Sunaj Mustafi**
student i inxhinjerisë
-  **Zihshan Limani**
farmaciste
-  **Sadik Abdurahimi**
ekonomist/udhërrëfyes malor
-  **Hana Musai**
ekonomiste
-  **Ahmed Abdullai**
programer
-  **Luljeta Abazi**
arkeologe
-  **Nezafet Idrizi**
teknologe (kimiste teknike)
-  **Mislum Hasipi**
mësues